



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1719 Prot

Tiranë, më 30 /10/2019

REKOMANDIM

Nr. 52, datë 30 /10/2019

PËR PROGRAMIN E TRANSPARENCËS  
SË AUTORITETIT PUBLIK "KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT"

Në mbështetje të neneve 6, 7 të Ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", shkronjës f) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka kryer monitorimin on-line në faqen zyrtare <http://kpk.al/programi-i-transparences/#tab-1-2-informacioni-qe-behet-publik-pa-kerkese>, të Autoritetit Publik "Komisioni i Pavarur i Kualifikimit" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Autoritetet Publike bazuar në pikën 1 të nenit 4 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", kanë detyrimin të vënë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publik të këtij informacioni.

Gjithashtu, bazuar në pikën 2 të po të njëjtës dispozitë, në përgatitjen e programit të transparencës, Autoriteti Publik mban parasysht interesin më të mirë të publikut dhe sidomos:

- a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;
- b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;
- c) modelet e miratuara për kategorinë e Autoritetit Publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji.

Ky program, vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik ndërton dhe rrit transparencën në veprimtarinë e tij institucionale, nëpërmjet përditësimit dhe pasurimit të vazhdueshëm të Programit të Transparencës, në referencë edhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Në përputhje me programin e transparencës të miratuar për çdo Autoritet Publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e informacionit të përcaktuara në nenin 7 të ligjit të sipërcituar.

Në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në ligj, u krye monitorimi me qëllim verifikimin e zbatimit të programit të transparencës në faqen zyrtare të Autoritetit Publik. Nga monitorimi rezultoi se, Autoriteti Publik ka publikuar në shiritin e menu-së kryesore menu-në “Programi i Transparencës” dhe programi i transparencës aksesohet përmes rubrikës “Informacioni që bëhet publik pa kërkesë”.

Nga verifikimi i rubrikave të programit rezultoi se, kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t’u bërë publik pa kërkesë në përputhje me nenin 7 të ligjit, janë pasqyruar në mënyrë jo të plotë në programin e transparencës.

Programi i transparencës duhet të jetë i plotësuar me të gjithë elementët sikurse parashikohet në ligj, si dhe i plotësuar me informacion specifik sipas fushës së veprimtarisë së çdo Autoriteti Publik.

Në lidhje me monitorimin e kryer Zyra e Komisionerit vlerëson se, problematikën e evidentuara konsistojnë në mosvënien në zbatim të programit të transparencës, në përputhje me modelin e miratuar nga Komisioneri.

Nga monitorimi u konstatua se nuk është publikuar informacioni në përputhje me nenin 7 pika 1 e ligjit, konkretisht për gërmat:

*dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;*

*gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;*

Disa kategori të informacionit publik sipas kërkesave të nenit 7 pika 1 e ligjit, gjenden të publikuara pjesërisht në faqen zyrtare të autoritetit, si dhe nuk janë të ndërlidhura me tabelën e programit (të pa linkuar). Konkretisht si më poshtë:

*e) çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit;*

ë) informacion për i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;

g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik.

Në përfundim, bazuar në provat dhe konstatimet që rezultuan nga monitorimi, u hartua raporti i monitorimit.

Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se një pjesë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë është publikuar në faqen zyrtare, Autoriteti Publik duhet ti përmbahet programit model të transparencës të miratuar nga Komisioneri.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 4, 5, 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, shkronjës f) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar,

#### REKOMANDOJ :

1. Autoriteti Publik/Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në zbatim të gërmave a), b), c) të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të rishikojë/përditësojë programin e transparencës;
2. Autoriteti Publik duhet të pasqyrojë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7 të ligjit;
3. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 dhe 2 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 90 (nëntëdhjetë) ditë nga momenti i marrjes dijeni;
4. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 18, 19 dhe 20 të ligjit nr. 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 30.10.2019

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

## Raport monitorimi mbi implementimin e programit të transparencës së Autoritetit Publik/ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit – datë 12.10.2019

1. **Komisioni i Pavarur i Kualifikimit** ka publikuar programin e transparencës në faqen zyrtare në linkun: <http://kpk.al/programi-i-transparences/#tab-1-2-informacioni-qe-behet-publik-pa-kerkese>.

Nga monitorimi i faqes rezulton se, autoriteti publik ka publikuar në shiritin e menu-së kryesore menu-në “Transparenca”, në nën menu-në “Informacioni që bëhet publik pa kërkesë”, rubrika “Programi i transparencës” programin e transparencës.


The screenshot shows the website of the Independent Commission for the Qualification of Judges and Prosecutors (KPK). The main navigation bar includes links for 'Kreu', 'Rreth Nesh', 'Legjislacioni', 'Denonco', 'Programi i Transparencës', 'Njoftime', 'Vendime', and 'Kontakt'. The 'Programi i Transparencës' section is active, displaying a table with the following content:

| Mekanizmat monitorues:                       | Neni 7/1 të ligjit nr. 119/2014 | Raportet monitorimi dhe auditimi (KLSH) | Menjëherë pas depozitimit në KPK ose publikimit në faqen zyrtare të autoritetit monitorues | Në faqen zyrtare, në menunë "Publikime"                      | Drejtoria Ekz. dhe Shërbim. Mbrojtëse Speciale i F. |
|----------------------------------------------|---------------------------------|-----------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------|
| dokumentat me tragje performance             |                                 |                                         |                                                                                            |                                                              |                                                     |
| Buxheti                                      | Neni 7/1 të ligjit nr. 119/2014 | Buxheti Raporte                         | Menjëherë pas miratimit të ligjit të buxhetit                                              | Në faqen zyrtare, në menunë "Rreth nesh- Buxheti/prokurimet" | Drejtoria Ekz. dhe Shërbim. Mbrojtëse Speciale i F. |
| Plani financiar për vitin financiar në vijim |                                 |                                         |                                                                                            |                                                              |                                                     |
| Informacion për procedurën                   | Neni 7/1 të ligjit nr. 119/2014 | Rregullat e procedurës së               | Menjëherë pas dërgimit në APP                                                              | Në faqen zyrtare, në menunë "Rreth nesh- Buxheti/prokurimet" | Drejtoria Ekz. dhe Shërbim. Mbrojtëse Speciale i F. |

Below the table, the section 'LIDHJA NR. 1' is displayed, containing the full text of the 'Programi i Transparencës' for the Independent Commission for the Qualification of Judges and Prosecutors. The text outlines the purpose of the program, its legal basis, and the commitment to transparency and accountability.

Programi i transparencës është i publikuar në përputhje me programin model të transparencës të miratuar sipas Urdhërit nr.14 date 22.01.2015. Nga monitorimi rezulton se kategoritë e


informacionit të programit model të transparencës, pjesërisht janë të ndërlidhura (të linkueshme) me faqen kryesore në të cilën ndodhet informacioni.



**TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË KPK**

| Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë | Baza ligjore                     | Dokumenti/Përmbajtja                                                                                                                | Afati kohor për publikim                 | Mënyra e publikimit                     | Struktura përgjegjëse për gatitje materiale disponim |
|----------------------------------------------|----------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------|-----------------------------------------|------------------------------------------------------|
| Përshkrim i strukturës organizative          | Neni 71(1) i Ligjit nr. 119/2014 | Veprimi i Kushtetutës nr. 85/2017 "Për ndalimin e strukturës organizative organizatave dhe kasatë mbi pasqerë të personelit të KPK" | Mënyherë pas bodimit në Fletorën Zyrtare | Në faqen zyrtare në menunë "Rreth nesh" | Drejtoria Ekz. dhe Shërbim. Informetësë (burimeve)   |

7.1.a) Një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik. Informacioni gjendet i publikuar në faqen e autoritetit dhe është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës;



**Misioni**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është organ kushtetues i përbërë nga 12 komisionerë, të miratuar në bllok me vendimin nr.82/2017 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Veprimtaria e institucionit bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 84/2015 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Rregulloren e veprimtarisë së KPK-së, si dhe në legjislacionin vendas dhe ndërkombëtar.

Procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve kryhet mbi bazën e tre kritereve:

Lexo më Shumë

1. vlerësimi i pasurisë;
2. kontrolli i figurës;
3. vlerësimi i aftësive profesionale;




Table e funksioneve, detyrave dhe kompetencave të drejtorëve/ive dhe strukturave përbërëse

| Nr. | Drejtoria                                                                                                                                                                                                                                                                                       | Detyrat funksionale                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | Arsimi dhe kualifikimet e drejtuesve/CV      |
|-----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------|
| 1.  | Sekretari i Përgjithshëm<br>Ramadan Çako                                                                                                                                                                                                                                                        | Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për administrimin e çështjeve që kanë lidhje me administratën, duke i programuar, planifikuar dhe monitoruar ato, me qëllim përbashkët të misionit dhe objektivave të institucionit.                                                                                                                                                                                | Sekretar i Përgjithshëm<br>Ramadan Çako (CV) |
| 2.  | Drejtoria e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun<br>- Drejtor _____<br>- Specialist sekretariat gjyqësor<br>Anna Duka<br>Denisa Kuna<br>Ina Serjantaj<br>Olinda Gashaj<br>- Specialist për shprehjen dhe redaktimin e vendimeve:<br>Klodian Dhamaj<br>Valbona Xhamo | Drejtoria e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun ka si funksion bashkëbrendshëm e punës, me qëllim menaxhimin e çështjeve që do të shqyrtohen nga KPK-ja sipas ligjit, përfshirë proceset, aktet procedurale dhe vendimeve që merren nga komisionet, dhënia e informacionit median dhe publikut, marrjen dhe administrimin e ankesave të paraqitura për subjektet e rivlerësimit. | Drejtori Agim Paskali (CV)                   |

7.1.b) tekstet e plota: i) të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë; ii) të ligjeve; iii) të akteve nënligjore; iv) të kodeve të sjelljes; v) të çdo dokumenti politikash; vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë. **Informacioni gjendet i publikuar në faqen e autoritetit dhe është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës;**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

Kreu Rreth Nesh Legjislacioni Denoncimi Programi i Transparencës Njoftime Vendime Kontakte

Baza Ligjore

Vendime Juridike

Aktet e Komisionit

Aneksi kushtetues  
Rivlerësimi kalimtar i gjyqtareve

1 Me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, zbatimi i disa neneve të kësaj Kushtetute, veçanërisht i neneve që lidhen me të drejtën për respektimin e jetës private, si dhe nenet 36 dhe 37 dispozitat që lidhen me barrën e provës, nenet 128, 131, nënparagrafi "f", 135, 138, 140, 145 paragrafi 1, 147/a, paragrafi 1, nënparagrafi "b", 148/a, paragrafi 1, nënparagrafi "b", kufizohen pjesërisht, sipas nenit 17 të Kushtetutës.

LEXO

Ligji Nr.84/2016  
Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjithë subjekteve të rivlerësimit për të parantuar funksionimin e shtetit të së

Formulari i shërbimit të mediave

Formulari i denoncimit

7.1.c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës. **Informacioni është i publikuar në faqe dhe i ndërlidhur me programin e transparencës,**

KËRKESË PËR INFORMACION

|                         |                                                              |                                              |
|-------------------------|--------------------------------------------------------------|----------------------------------------------|
| Emër Mbiemër:<br>I. Inj | Adresa postare: _____<br>Adresa elektronike<br>Nr. Tel _____ | Data: ____/____/201____<br>Nënshkrimi: _____ |
|-------------------------|--------------------------------------------------------------|----------------------------------------------|

*ndërgjimi i kërkesës elektronike: kërkesë emër, mbiemër, adresë dhe dokumente identifikuese të shkruara*

|                                                 |
|-------------------------------------------------|
| Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar |
|                                                 |
|                                                 |
|                                                 |
|                                                 |
|                                                 |
|                                                 |
|                                                 |
|                                                 |
|                                                 |
|                                                 |

|                   |
|-------------------|
| Të tjera të dhëna |
|                   |
|                   |
|                   |

Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni: \_\_\_\_\_

FORMULAR ANKESE

Drejtuar  
Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Në bazë të Ligjit Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit"

|                 |
|-----------------|
| Emri / Mbiemri: |
| Adresa:         |
| Qyteti:         |
| Telefon:        |
| E-mail:         |

|                    |
|--------------------|
| Autoriteti Publik: |
| Adresa:            |
| Qyteti:            |

*Identifikoni saktë Autoritetin Publik/Institucionin ndaj të cilit ankohen.*


Përkrahni çdo veprim të pretenduar si shkolje nga Autoriteti Publik dhe nëse dispononi dokumente bashkëlidhni ato.

\_\_\_\_\_


\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_


7.1.ç) të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinitorit për të drejtën e informimit. **Informacioni është i publikuar në faqe, si dhe i ndërlidhur në programin e transparencës;**



7.1.d) një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime. **Informacioni gjendet i publikuar në faqe dhe është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës;**



7.1.dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit. **Informacioni nuk është i publikuar në faqen e autoritetit (rezulton i publikuar vetëm një raport statistikor).**



7.1.e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara. **Informacioni është pjesërisht i publikuar në faqe dhe është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës (vetëm buxheti).**

Programi i Transportit X Programi i Transportit X Ekuiv. J.12 p.11 X Programi i Transportit X Shërbime - DPE X Projektivatore X

Not secure | kpk.al/wp-content/uploads/2019/03/Buxheti-2019.pdf

Buxheti-2019.pdf 1/1

|    |       |                                                 |     | 880              | 801                             | 802                     | 221                              | Totali  |
|----|-------|-------------------------------------------------|-----|------------------|---------------------------------|-------------------------|----------------------------------|---------|
| Id | Ti    | Qasim i mullazmave Buxhetit i Programit         | Kap | Etna Kapitali    | Korrekta e Sigurimeve Shqiptare | Mbështetje dhe Shërbime | Shpenzime Kapitule të Tripartite | Totali  |
| 63 | 03030 | Veprimet e rregullimit kalimtar të regjistrimit | 1   | Chet nga Buxheti | 142 900                         | 13 500                  | 32 000                           | 4 000   |
|    |       |                                                 |     |                  |                                 |                         |                                  | 191 600 |


4:42 PM 10/12/2019

7.1.ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”. dhe të ligjit nr. 125/2013. “Për koncesionet dhe partneritetin publik



7.1.f) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit - **Informacioni është i publikuar në faqe dhe është i ndërlidhur me tabelën e programit model të transparencës.**

7.1.f) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit - **Informacioni është i publikuar në faqe dhe është i ndërlidhur me tabelën e programit model të transparencës.**



7.1.g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik. **Informacioni është i publikuar në faqe por nuk është ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës;**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

Kreu Rreth Nesh Legjislacioni Denoncimi Programi i Transparencës Njohime Vendime Kontaktë

## Formulari i Denoncimit

### FORMULAR I DENONCIMIT NGË PUBLIKU

(Bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016 "Për rievlerësimin kalimtar të qytetarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë")

#### TË DHËNAT E DENONCUESIT

Emër \*      Mbiemër \*

Numri personal i identifikimit \*

Adresa

#### UDHEZIM PËR PLOTËSIMIN E KETIJ FORMULARI\*\*

1. Zgjidhni kutinë përkatëse, sipas kriterit të rievlerësimit.
2. Përshtuni në mënyrë të detajuar dhe të saktë të gjitha të dhënat rreth subjektit dhe shkakës ligjore që po denonconi, në kutinë përkatëse.
3. Bashkëdhëni me këtë Formular Denoncimi të gjitha provat, si dokumenta ligjorë, fotografikë, apo çdo të dhënë, që vërteton shkakësin e denoncuar.
4. Në rast se kemi nevojë për ndihmë në plotësimin e formularit, ju lutem drejtohuni pranë zyrtarëve të institucionit, të cilët i drejtohet ky denoncim.

7.1.gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik; - **Informacioni nuk është i publikuar në faqe pavarësisht se citohet në tabelën e programit model të transparencës.**


7.1.h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë; - **Informacioni është i publikuar në faqe si dhe është ndërlidhur në programin e transparencës;**

Programi i Transparencës - KPK

Lista tip e dokumenteve dhe afatet përkatëse të ruajtjes

| Nr. | Emërtimi                                                                                                           | Afati i ruajtjes   |
|-----|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|
| 1.  | Dokumente për krijimin, organizimin dhe funksionimin e KPK-së<br>- Vendime<br>- Skema organizative<br>- Rregullore | Ruhen përgjithmonë |
| 2.  | Dokumente të miratara nga Mbledhja e Komisionit                                                                    | Ruhen përgjithmonë |
| 3.  | Dokumente të veprimtarisë punës së KPK-së<br>- Vendimet                                                            | Ruhen përgjithmonë |
| 4.  | Korrespondenca me institucione                                                                                     | Ruhen përgjithmonë |
| 5.  | Korrespondencë e thjeshtë për marrëdhëniet me publikun<br>- Kërkesa<br>- Anketa                                    | Ruhen 5-10 vjet    |
| 6.  | Dokumente për strukturën organizative, kategorizimin dhe fondin e pagave                                           | Ruhen përgjithmonë |


7.1.i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji - **Informacioni është i publikuar, i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës si dhe është i përditësuar.**



7.1.k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh– **Informacioni është i publikuar në faqe dhe është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës;**



7.1.1) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik . **Informacioni është i publikuar faje dhe i ndërlidhur në tabelën e programit model të transparencës.**



| Autoriteti Publik                                    | Komisioni i Pavarur i Kualifikimit |
|------------------------------------------------------|------------------------------------|
| Programi i transparencës                             | Po                                 |
| Koordinatori                                         | Po                                 |
| 7.1.aPërshkrim/struktura, funksionet dhe detyrat A.P | Po                                 |
| 7.1.b Tekst. e plota të konventa, ligje, akteve      | Po                                 |
| 7.1.c Procedura për kërkesë për informacion          | Po                                 |
| 7.1.ç Të dhënat e vendodhjes së AP                   | Po                                 |
| 7.dTë dhënat për arsim,pagat                         | Po                                 |
| 7.1.dh Auditi                                        | Jo                                 |
| 7. 1.e Buxheti                                       | Po                                 |
| 7.ë Procedurat e Prokurimit                          | Pjesërisht                         |
| 7.1.f Shërbimet e A.P                                | Po                                 |
| 7.1.g Procedura për ankesë për veprimtarinë e AP     | Po                                 |
| 7.1.gj Mekanizma për dhënien e mendimeve             | Jo                                 |
| 7.1.h Mbajtja e dok(Arkiva)                          | Po                                 |
| 7.i Regjistri i kërkesave                            | Po                                 |
| 7.1.k Dokumente që kërkohen shpesh                   | Po                                 |
| 7.1.l Çdo Informacion i dobishëm                     | Po                                 |